

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTERE REZARTA B. KOÇI

Nr. 1527 Rep.

Nr. 818 Kol.

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
SHOQERISE "AIC COMPANY" sh.p.k .



Në Tiranë, sot më 04.04.2016 (dymijë e gjashtëmbëdhjetë), para meje noteres publike Rezarta B. Koçi, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në rrugën “Bulevardi Zogu i Parë”, pranë “Ministrisë së Drejtësisë”, Njësia Bashkiake Nr. 9, u paraqit personalisht:

THEMELUESI:

Z.Ylli Zyla, i biri i Xhafer-it, me datëlindje 25.04.1970, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektëk me nr 024741411 dhe me nr personal H00425281M.

Znjsh. Arba Zyla, e bija e Yllit, me datëlindje 16.03.1995, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektëk me nr 032059507 dhe me nr personal J55316059N.

Z. Ron Meloka, i biri Yaacov, me datëlindje 28.10.1961, lindur në Izrael, dhe banues në Izrael, shtetas izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr 10939244, **i përfaqësuar me prokurë lëshuar më datë 30.03.2016, nga Z.Ylli Zyla (bashkangjitur prokura).**

Znj. Haya Meluka, e bija e Moshe, me datëlindje 13.12.1960, lindur në Izrael, dhe banues në Izrael, shtetase izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr 20984017. **i përfaqësuar me prokurë lëshuar më datë 30.03.2016, nga Z.Ylli Zyla (bashkangjitur prokura).**

Znj. Netta Aylon, e bija e Michael, me datëlindje 14.02.1975, lindur në Izrael, dhe banuese në Izrael, shtetase izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr. 13164423 **i përfaqësuar me prokurë lëshuar më datë 30.03.2016, nga Z.Ylli Zyla (bashkangjitur prokura).**

Z. Michael Ayalon, i biri i Haim, me datëlindje 12.10.1945, lindur në Morocco, dhe banues në Izrael, shtetas izraelite, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr 22372594, **i përfaqësuar me prokurë lëshuar më datë 31.03.2016, nga Z.Ylli Zyla (bashkangjitur prokura).**

hartojmë këtë statut të shoqërisë " AIC COMPANY" Sh.p.k, mbështetur në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshtë.

NENI 1

Te krijoj shoqërinë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar " AIC COMPANY" Sh.p.k., e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 datë 14.04.2008 dhe formalitetet që duhen plotësuar në të.

Kjo shoqëri do të emërtohet " AIC COMPANY" Sh.p.k

NENI 2

Shoqëria "AIC COMPANY" sh.p.k. do të ketë Qendrën në Tiranë Rr. " Bulevardi Deshmoret e Kombit", Kulla e dytë , nr pasuire 3/329+2-N30, Zona kadastrale 8270, volum 29, faqe 45, Tiranë dhe do të ushtroje veprimtarinë e saj private për një periudhë kohore të paktën 15 vjet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 3

Fusha e veprimtarisë së shoqërisë do të jenë:

- **agrikultre (inputet, njohuri, zhvillimi rural, menaxhim projektsh etj)**
- **agrobiznesi**
- **tregëtimi**
- **infrastruktura**
- **gërmimi dhe mineralet**

Shoqëria do të merret me Eksport-Import dhe tregtim me shumice dhe pakice të të gjithë llojeve të materialeve e pajisjeve të ndertimit, të mallrave të ndryshme industrial e ushqimore dhe mallrave të të gjitha llojeve. Të ushtroje veprimtarinë e ndermjetesimit apo të lidhjes së kontratave ndermjet personave fizik apo juridik, publik, shtetëror e privat vendas e të huaj. Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm me të. Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të hapë njësi menaxhuese , magazinuese, shërbim tregtimi, duke bashkëpunuar me persona fizik e juridik vendas dhe të huaj. Shoqëria do të kryejë të gjitha llojet e aktivitetëve tragtare me qëllim realizimin e veprimtarive të përkrahura me siper. Shoqëria do të kryejë Investime për prodhimin, grumbullimin, përpunimin, ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin për vend e eksport të produkteve bujqësore e blektorale, do bëjë transport të mallrave e pasagjereve, do kryejë investime në pasuritë e palujtshme, kryesisht për toka e ndertesa në funksion edhe të aktivitetëve të tjera, etj.

Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtë të marrin vendim për të shtuar objektin e veprimtarisë së shoqërisë ”

NENI 4

Shoqëria mund të shtojë vendqëndrimin, ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë së saj, me vendim të ortakëve sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë: 10.800 (dhjetë mijë e tetëqind lekë) leke të reja e përbërë nga gjashtë kuota dhe i përket ortakëve si më poshtë.

1. Msc.Av.Ylli Zyla	me 24 % të kuotave = (2592 leke)
2. Arba Zyla	me 9% të kuotave = (972 lekë)
3. Ron Meloka	me 20 % të kuotave = (2160 lekë)
4.Haya Meluka	me 13 % të kuotave = (1404 lekë)
5. Netta Aylon	me 17 % të kuotave = (1836 lekë)
6. Michael Ayalon	me 17 % të kuotave = (1836 lekë)

NENI 6

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrë ortaku, por në asnjë rast njeri ortak nuk mund të detyrohet ortakët e tjerë të rrisin kuotën e tyre në kapitalin e shoqërisë.

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të vërtetuara në dokumentet financiare, rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortakët vendosin brenda tre muajve nga miratimi i

llogarive te përcaktojnë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes se parakohshme te shoqërisë. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë jo me te vogël se ajo e humbjeve qe kane mbetur pa mbuluar fondet rezerve.

NENI 7

Ortaku qe ka ndërmend t'u shesë te tretëve kuota te kapitalit te tij, tërësisht apo pjesërisht, duhet te njoftoje me pare ortaket e tjerë te shoqërisë, te cilët kane te drejtën e parablerjes qofte dhe ne kushte te ndryshme. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 60 ditëve nga data e komunikimit.

Si fillim, kuotat e secilit ortak do ti ofrohen për shitje/dhurim brenda ortakëve të shoqërisë dhe drejta e parablerjes do te jete:

Ylli ia ofron për blerje/pranim dhurimi fillimisht Arbës dhe anasjelltas;

Ron ia ofron për blerje/pranim dhurimi fillimisht Haya dhe anasjelltas.

Netta ia ofron për blerje/pranim dhurimi fillimisht Michael-it dhe anasjelltas.

Në rast se personat e sipërcituar nuk pranojnë dhurimi apo të blejnë aksionet sipas ndarjes përkatëse të mësipërme, atëherë secili prej ortakëve ka të drejtë që kuotat e veta, t'jua ofroj për shitje/pranim dhurimi të gjithë ortakëve të tjerë të shoqërisë në mënyrë të barabartë (dmth kuotat me përqindje të barabartë për të gjithë ortakët e shoqërisë)

Në rast se njëri prej ortakëve nuk pranon të blej/pranoj dhurimin e kuotave të ortakut i cili ka ofruar blerjen/pranimin e dhurimit, atëher kuotat e këtij të fundit do tu ofrohen në mënyrë të barabartë për blerje/ pranim dhurimi pjesës mbetëse të ortakëve të cilët shfaqin interes.

Kjo procedurë do të jetë e tillë derisa në shoqëri do të ketë interes qofte dhe vetëm njëri prej ortakëve për blerjen/pranimin e dhurimit të kuotave të ortakut i cili ka ofruar blerjen/pranimin e dhurimit të kuotave të veta.

Në këtë rast çmimi (në rast shitje) do të jetë 10% më pak sesa vlera në rast se do të blihej nga të gjithë ortakët.

Në rast se asnjëri prej ortakëve nuk do që të blejë/pranoj kuotat e ofruara nga njëri prej ortakëve, atëherë personi që do të shesë kuotat ka të drejtë ti shesë te persona të tretë (një kompani tjetër) gjithmonë duke marrë pëlqimin e ortakëve të shoqërisë.

NENI 8

Organet drejtuese te shoqërisë jane:

- Asambleja e ortakeve.(Msc.Av.Ylli Zyla, Arba Zyla, Ron Meloka, Haya Meluka, Netta Aylon, Av.Michael Ayalon).
- Bordi drejtues (Msc.Av.Ylli zyla, Ron Meloka dhe Av.Michael Ayalon), i zgjedhur nga të gjithë ortakët e shoqërisë.
- Administratori (Msc.Av. Ylli Zyla)
- Këshilluesi dhe menaxher projektsh. (Av.Michael Ayalon)
- Marketing (Ron Meloka)
- Llogaritari (punonjës të tjerë), do të punësohen nga administratori.

Procedura për emërimin ne funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit te shoqërisë.

NENI 9

Administrator i shoqërisë është **Msc.Av.Ylli Zyla**, i biri i Xhaferr-it, me datëlindje 25.04.1970, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektëk me nr 024741411 dhe me nr personat F100425281M.

NENI 10

Vendimet e Asamblesë janë te vlefshme ne se janë miratuar nga ortakët e saj sipas dispozitave te Ligjit Për Shoqëritë Tregtare.

Në rast mosmarrëveshjes do të thirret një ndërmjetësi licensuar për të bërë ndërmjetësimin për zgjidhjen e tyre.

NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar te shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do te shënohet kontributi i ortakut te vetem. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave te ligjit për kontabilitetin si dhe gjithë kërkesave te tjera financiare, te domosdoshme për veprimtarinë normale te saj.

NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do te ndahet ndërmjet ortakëve të shoqërisë mbasi te jene likuiduar te gjitha detyrimet, dhe te jete hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezervës ligjore deri ne përmbushjen e 1/10 te kapitalit te shoqërisë. Kjo mënyrë shpërndarje të ardhurash do të jetë e vlefshme deri në daljen e nje vendimi nga ana e Bordit Drejtues të Shoqërisë, i cili mund të sjellë ndryshime përsa i përket kësaj shpërndarje të ardhurash.




NENI 13

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi te ketë marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua ne shtatë dokumente origjinale me fuqi te barabarte secila.

ORTAKËT:**Ylli Zyla**

Arba Zyla**Ron Meloka**

Netta Aylon

Michael Ayalon

Haya Meluka

NOTERE




שיום לב - פרט לחתימה אינך רשאי לרשום בעצמך דבר בדרך

השם במלואו
או השם הקודם

in full
or former name _____

שם נעורים
Maiden name _____

Passport valid for כל הארצות All countries

חתימת בעל הדרבון

On receipt of passport sign here 

בקבלך את הדרבון
חתום כאן 

..... שונה - ראה עמוד amended - see page

PASSPORT דרבון	STATE OF ISRAEL מדינת ישראל	Passport No. / מס דרבון 22372594
Type / סוג P / ד	Code of State / סמל המדינה ISR	שם משפחה אילון
Surname AYALON	Given name MICHAEL	שם פרטי מיכאל
Nationality ISRAELI	Place of birth MOROCCO	אזרחות ישראלית
Date of birth / תאריך לידה 00/00/1945	Sex / מין M / ז	I.D. No. / מס זהות 0-0236744-9
Date of issue / תאריך הוצאה 03/08/2015	Authority - I.C. Passport at RAMLA	מקום לידה מרקוק
Date of expiry / תאריך פקיעת תוקף 02/08/2025		סמכות - מסוננת דרכונים ב- רמלה

22372594<8ISR4500003M25080270<0236744<9<<<<10



LETËRNJOFTIM ID REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

Zyla
emri/given name

Ylli
shqetësia/nationality

Shqiptare/Albanian
vendndaj/place of birth

Tepelene
data lindja/date of birth

25-04-1970
data e lëshimit/date of issue

30-03-2009
autoriteti lëshues/authority

MB

nr. letërnjoftimi/card no.
024741411

gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
29-03-2019
nr. personal/personal no.
H00425281M

LETËRNJOFTIM ID REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

Zyla
emri/given name

Arba
shqetësia/nationality

Shqiptare/Albanian
vendndaj/place of birth

Tirane
data lindja/date of birth

16-03-1995
data e lëshimit/date of issue

25-01-2013
autoriteti lëshues/authority

MB

nr. letërnjoftimi/card no.
032059507

gjinia/sex
F
data e skadimit/date of expiry
24-01-2023
nr. personal/personal no.
J55316059N